



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 prill 2016
Nr. ref.:RK925/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI124/15

Parashtrues

Arif Kryeziu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërfshirjes në procesin e privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore “Liria”

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Arif Kryeziu nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e konteston asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik. Ai vetëm kërkon të përfshihet në listën e punëtorëve të cilët përfitojnë nga një pjesë e të ardhurave nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore “Liria” nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: NSH “Liria”).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet për shkak të mospërfshirjes së tij në listën e punëtorëve që përfituan 20% të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes NSH “Liria”.
4. Parashtruesi ka parashtruar më parë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) një kërkesë identike (KI19/15).
5. Parashtruesi i kërkesës nuk thirret në asnjë shkelje kushtetuese.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatë

7. Më 16 tetor 2015, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë kërkesën KI124/15.
8. Më 5 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 9 dhjetor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe në pajtim me rregullin 29 të Rregullores së punës, kërkoi nga ai që ta plotësojë kërkesën e tij. Një kopje e kërkesës i ishte dorëzuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).
10. Më 28 janar 2016, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që të sqarojë nëse ai ka parashtruar ndonjë ankesë. Megjithatë, parashtruesi nuk iu përgjigj kësaj kërkesë.
11. Më 9 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 23 shkurt 2015, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë kërkesën KI19/15, e cila ishte hequr nga lista më 23 shtator 2015.

13. Më 6 tetor 2015, parashtruesi parashtrroi kërkesë në AKP në lidhje me mospërfshirjen e tij në listën e punëtorëve që përfitojnë nga një pjesë e të ardhurave nga shitja e NSH "Liria".
14. Më 6 tetor 2015, AKP-ja e njoftoi parashtruesin e kërkesës se të gjithë punëtorët që nuk ishin përfshirë në listë për të përfituar nga shitja e NSH "Liria" kanë të drejtë ankese.
15. Pjesa përkatëse e njoftimit të lartcekur të AKP-së thekson se "(...) data e fundit për ankim kundër listës fillestare ishte dt. 24.12.2011" dhe "data e fundit për ankimin kundër listës përfundimtare ishte dt. 31.03.2012".
16. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës nuk është përgjigjur lidhur me sqarimin e kërkuar më 28 janar 2016 dhe nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se ai ka parashtruar ankesa në AKP apo në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, dhe as ushtruar të drejtën e tij për ankese, në pajtim me udhëzimin e AKP-së dhe me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.

Prendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti; por ai thekson: *"Bazohem tek ju, sepse kam arsye. Nuk më jep të drejtën time askush, pos jush"*.
18. Parashtruesi ka renditur vendimin për heqjen e kërkesës nga lista në Rastin nr. KI19/15, si vendim të fundit në rastin e tij. Megjithatë, ai nuk thekson asnjë ankese në lidhje me atë vendim.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

21. Gjykata i referohet edhe nenit 47 të Ligjit, i cili parasheh:

"Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik."

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

22. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës i cili saktëson:

(1) *Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

(a)...

(b) *janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar.*

23. Gjykata vlerëson se kërkesa KI19/15 ishte hequr nga lista, sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte saktësuar “*aktin konkret të autoritetit publik*” dhe nuk kishte ofruar “*dokumente mbështetëse dhe prova materiale*”, siç kërkohet me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit, dhe rregullin 29 (2) (h) të Rregullores së punës.
24. Gjykata vëren se në kërkesën e tanishme KI124/15, parashtruesi ishte pyetur nëse ai kishte ushtruar të drejtën e tij për ankesë, siç ishte udhëzuar me njoftimin e AKP-së të 6 tetorit 2015. Parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se ai ishte ankuar në pajtim me njoftimin e AKP-së apo me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.
25. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u ankuar më tej dhe në këtë mënyrë nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion me ligjin e zbatueshëm në Kosovë (Shih, për shembull, Rastin nr. KI07/09, *Demë dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 majit 2010, paragrafët 28-29 shih gjithashtu *mutatis mutandis* Rasti nr. KI39/11, *Tomë Krasniqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 janarit 2013, paragrafi 44).
26. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih Rastin nr. KI116/14, *Fadil Selmanaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 janarit 2015, paragrafi 48).
27. Nga sa u tha më lart, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak se nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe të specifikuar më tej në nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 9 mars 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi